**VENDIM**
**Nr. 229, datë 21.3.2017**

# PËR RISHPËRNDARJE FONDESH TË INFRASTRUKTURËS VENDORE DHE RAJONALE, NGA MINISTRIA E ZHVILLIMIT URBAN NË DISA NJËSI TË QEVERISJES QENDRORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të shkronjës "a", të nenit 44, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 18, të ligjit nr. 130/2016, "Për buxhetin e vitit 2017", me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Fondet buxhetore, të miratuara në buxhetin e vitit 2017 për Ministrinë e Zhvillimit Urban, në programin "Infrastruktura vendore dhe rajonale", rishpërndahen në disa institucione qendrore, që janë autoritete kontraktuese, për financimin e projekteve në vazhdim, të infrastrukturës vendore dhe të programit "Shqipëria dixhitale", sipas tabelës 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Ngarkohen Ministria e Zhvillimit Urban, Ministria e Financave, Fondi Shqiptar i Zhvillimit, Agjencia për Zbatimin e Reformës Territoriale dhe Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Edi Rama**

TABELA NR.1

RISHPERNDARJA E FONDEVE BUXHETORE PËR PROJEKTET NË VAZHDIM TË FZHR, PËR NJËSITË QENDRORE

ne leke

| Entiteti Qeverises | Grupi | Kodi institucionit | Emertimi I Institucionit | Kapitulli | Programi | Llog. ekon. | Kodi i Thesarit | Kodi i projektit | Shuma | Emertimi i projektit te investimit |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **PAKËSOHET** | | | | | | | | | | |
| 001 | 94 | 1094001 | Aparati I MZHU | 01 | 06210 | 2310000 | 3535 | M940115 | 625,400,757 | Fondi i Zhvillimit të Rajoneve |
| **Totali i pakesimeve** | | | | | | | | | **625,400,757** | |
| **SHTOHET** | | | | | | | | | | |
| 001 | 56 | 1056001 | Fondi Shqiptar i Zhvillimit | 01 | 06210 | 2310000 | 3535 | M560410 | 9,185,683 | Rikonstruksioni i rrugës Bajram Curri - Vernice |
| 001 | 56 | 1056001 | Fondi Shqiptar i Zhvillimit | 01 | 06210 | 2310000 | 3535 | M560411 | 124,632,553 | Sistemim asfaltim i rrugës së Unazës Vlorë (Poliklinka 7_Pallatet) |
| 001 | 56 | 1056001 | Fondi Shqiptar i Zhvillimit | 01 | 06210 | 2310000 | 3535 | M560407 | 157,716,221 | Rikonstruksioni i Rrugës "Dhimitër Konomi", Vlorë |
| 001 | 87 | 1087018 | Agjensia per Zbatimin e Reformes Territoriale | 01 | 06210 | 2310000 | 3535 | M870157 | 2,879,800 | Sistemi i Menaxhimit te Arkivit dhe Protokollit ne Njesite e Qeverisjes Vendore dhe Infrastruktura per Dixhitalizimin e Dokumentave te ketyre Njesive. |
| 001 | 3 | 1003016 | AKSHI | 01 | 06210 | 2310000 | 3535 | M030077 | 666,000 | Promovim dhe vendosje sportelesh dixhitale për portalin e-Albania ( Faza Pilot ) |
| 001 | 3 | 1003016 | AKSHI | 01 | 06210 | 2310000 | 3535 | M030083 | 68,340,500 | PLATFORMA QEVERITARE E NDËRVEPRIMIT Riinxhinierim e modernizim të 51 proceseve të punës G2G, Zgjerim me 21shërbime të reja elektronike G2G, G2C dhe G2B dhe shtimi i 6 shërbime të reja në portalin qeveritar e-albania.al Versioni 1.0 |
| 001 | 3 | 1003016 | AKSHI | 01 | 06210 | 2310000 | 3535 | M030084 | 261,980,000 | Rritja e sigurisë fizike dhe dixhitale në shkolla të arsimit të mesëm,ndërtimi i platformës multidimensionale të komunikimit. |
| **Totali I shtesave** | | | | | | | | | **625,400,757** | |